



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

V E N D I M

Nr. 19, Datë 04/04/2017

Mbështetur në nenin 32, pika 1, germa a), të ligjit nr.10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, është paraqitur ankesa nr. nr. 12, datë 13.02.2017 e znj. *[Emri i ankesueses]*, përfaqësuar me prokurë të posaçme nga avokate *[Emri i avokates]* në të cilën pretendohet diskriminim nga ana e Drejtorisë Arsimore Vlorë.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I:

Mbështetur në ankesën e paraqitur, ankuesja, përmes përfaqësueses së saj, znj. *[Emri i ankueses]*, sqaron se znj. *[Emri i ankesueses]* ka aplikuar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB), për t’u pajisur me licencë për ushtrimin e veprimtarisë “Arsim Parashkollorë” (Kopshti “Happy Kids”), në Lagjen “Pavarësia”, Rruga “Mato Robi”, Pallati Nr. 1104, Kati I, Vlorë. Pas aplikimit, QKB e ka pajisur aplikuesen/ankuesen me NIUS L47102203J. Më pas, znj. *[Emri i drejtuarit]* është drejtuar Qendrës Kombëtare të Regjistrimit (QKR), për të bërë aplikimin përkatës, i cili po ashtu është pranuar si i rregullt dhe në përmbushje të kërkesave të ligjit.

Referuar shpjegimeve të mëtejshme, theksohet se pas këtyre veprimeve, në kopshtin e fëmijëve të hapur nga znj. *[Emri i drejtuarit]* është paraqitur znj. *[Emri i drejtuarit]*, Inxhinierë në Drejtorinë Arsimore Rajonale, Vlorë, për të bërë vlerësimin e përmbushjes së kushteve dhe kriterëve për dhënien e licencës, e cila ka udhëzuar që t’i kushtohej më tepër kujdes ndriçimit dhe tualeteve. Në pritje të dhënies së licencës, ankuesi është informuar se kërkesa i është refuzuar, me arsyetimin se “Objekti nuk përmbush standardet”. Pasi morëm masa për ndriçimin dhe tualetet, ribëmë aplikimin, kërkesa na

u refuzua përsëri me të njëjtin argument: “Objekti nuk përmbush standardet”. Ankuesja pretendon se Kopshti “Happy Kids” i plotëson më së miri kushtet e përcaktuara nga Udhëzimi i Ministrisë të Arsimit dhe Sportit, ndaj nuk e kupton shkakun e refuzimit të pajisjes me licencë nga znj. *Irinda Tahiri*, Inxhinierë në Drejtorinë Arsimore Rajonale, Vlorë.

Pas analizimit paraprak të ankesës, Komisioneri konstaton se:

- Ankuesja nuk ka evidentuar shkakun e diskriminimit të pretenduar. Për këtë arsye, me shkresë nr. 181. Prot, datë 16.02.2017, Komisioneri i është drejtuar znj. *Irinda Tahiri*, në cilësinë si përfaqësuese (e pajisur me prokurë të posaçme), e znj. *Irinda Tahiri*, ku i është kërkuar të evidentojë shkakun e diskriminimit të pretenduar nga ana e Drejtorisë Arsimore Rajonale Vlorë. Nga shqyrtimi i dosjes rezulton se nga pala ankuese nuk erdhi asnjë përgjigje, lidhur me kërkesën e mësipërme të Komisionerit.
- Shpjegimet e ankuses nuk hedhin dritë mbi situatën diskriminuese të pretenduar nga ankuesja.

Për sa më sipër, Komisioneri vlerësoi se ankesa nr. 12, datë 13.02.2017 e znj. *Irinda Tahiri*, nga pikëpamja formale, nuk plotëson kriteret ligjore të parashikuara në ligjin nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”.

Në nenin 33, pika 4, germa ç), parashikohet se :

“Ankesa nuk pranohet nëse:

- a).....
- b).....
- c).....

ç) është haptazi e pabazuar ose nuk ka informacion të mjaftueshëm për të bërë të mundur një hetim;

Për sa më sipër, duke analizuar në tërësi ankesën e znj. *Irinda Tahiri*, Komisioneri gjykon se për rastin konkret nuk ka informacion të mjaftueshëm për të bërë të mundur një hetim.

PËR KËTO ARSYE:

Mbështetur në nenet 3, 20, 21, pika 1, neni 32, pika 1, germa a), nenin 33, pika 4, germa ç) të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”,

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

VENDOSI:

1. Mospranimin e ankesës nr. 12, datë 13.02.2017 të znj. **Irma Tahiri**, pasi nuk plotëson kriteret ligjore të parashikuara në ligjin nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, brenda afateve të parashikuara me ligj.



Hartoi: _____
Pranoi: _____
Datë: 28.02/2017 / 04.04.2017

